**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

Komuna Podujevë / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

---

**KOMUNA E PODUJEVËS**
**DREJTORA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4, nenit 19 pika 1.19, të Statuit të Komunuës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dt 29.06.2018, nenit 27 dhe 28 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve, me nr. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, DKRS publikon:

# THIRRJE PUBLIKE

**Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës.**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, u bënë thirrje individëve, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve kulturore dhe artistike, duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.

2. Individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

3. Individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon jetën kulturore, përmes aktiviteteve si më poshtë:

**Ngjarje/Aktivitete kulturore, artistike, tradicionale:**

- *Artin pamor (ekspozita);*
- *Art në hapësira publike;*
- *Botim i librit dhe promovim;*
- *"Stand up" komedi;*
- *Aktivitete të tjera kulturore dhe artistike.*

**Objektivi i thirrjes:**

*Përfshirja e individëve në krijimin, masivizimin, rritjen e cilësisë, zgjerimin/shtrirjen e ngjarjeve/aktiviteteve kulturore dhe artistike.*

**Objektivat:**

- *Krijimi i ngjarjeve/aktiviteteve kulturore dhe artistike nëpërmjet partneritetit me individët në fushat e kulturës dhe arteve;*

- *Përfshirja ideve dhe potencialit të individëve në funksion të ringjalljes së jetës kulturore dhe artistike;*
- *Rritja e cilësisë së krijimtarive në kulturë dhe arte, nëpërmjet mbështetjes së ideve, propozimeve dhe ngjarjeve/aktiviteteve;*
- *Shtrirja dhe zgjerimi i ngjarjeve/aktiviteteve në zona rurale;*
- *Përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes në ngjarje/aktivitete të grupeve të margjinalizuara;*

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione për këto lloj projektesh për këtë vit është 10,000 € (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 300 € (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2,000€ (euro).

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 24.03.203 dhe përfundon me datën 06.04.2023 në ora 16:00.

6. Individët mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Periudha e zbatimit të projektit është 15.04.2023 - 25.12.2023.

**Kriteret e përgjithshme për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për projekte individuale:**

- Projektet duhet të zbatohen në Komunën e Podujevës;

- Projektet dhe individët aplikues mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;

- Individët të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje dhe nuk mund të përzgjidhen fituese;

- Projektet duhet të reflektojnë nevojat dhe objektivat e Komunës së Podujevës për këto fusha;

- Të mos ekzistoj konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/ udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

- Individët nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës;

- Individët duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si të cekura më lartë;

- Të dëshmoj kompetencë profesionale për zbatimin e projektit.

**Kriteret e veçanta:**

1. Art pamor:

   a) Portfolio e artistit/es;

   b) Listë e punimeve që prezantohen;

   c) Koncept vizual i veprës.

2. Art në hapësira publike:

   a) Portfolio e artistit/es;

   b) Listë e punimeve që prezantohen;

   c) Koncept vizual i veprës;

   ç) Të kërkohet leje nga drejtoria përkatëse komunale para aplikimit.

3. Botime librash:

   a) Biografi e autorit/es;

   b) Rezencion i veprës;

   c) Zjë pjesë e veprës që do të botohet;

   d) Prezantim i ilustrimeve (nëse ka);

   e) Marrëveshje me shtëpinë botuese (nëse ka).

4. Stand up comedy (komedi individuale)

   a) Biografi e performuesit

   b) Teksti i performancës

5. Në projekte të tjera kulturore, të ofrohen dëshmi të ngjashme me ato të sipërpërmendurat.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregullore per kushtet kriteret dhe procedurate ndarjes se Subvencioneve (2).pdf

**Kujdes: Aplikacionet të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.** Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.
Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: ***jakup.gashi@rks-gov.net* dhe *arber.sfishta@rks-gov.net* ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.**

<u>**Lista e dokumenteve të thirrjes publike**</u>

- **Për individët:**
  - Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të individit (JO kopje e kartelës bankare);
  - Kopjen e letërnjoftimit;
  - Deklarta për financimin e dyfishtë; (nëse ka)
  - Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike;
  - Formulari i propozim-buxhetit;
  - Krahas kësaj liste, varësisht nga fusha artistike, shtohen dokumentet e kërkuara tek kriteret e veçanta.

<u>**Vërejtje/Kujdes**</u>:

- ***Raporti Narrativ*** *- i cili përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit qoftë nëpërmjet dëshmive të fotografimit. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga <u>Personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione.</u> Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit projektit.*

*Raporti narrativ i përgatitur duhet të përfshij:*

- *Të përfshij dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve, etj).*
- *Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues të subjektit grantmarrës.*

- ***Raporti Financiar*** *– kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim iu është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor të projektit.*

*Raporti financiar i përgatitur duhet të deklarohet dhe:*

- *Të përshkruajë shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera;*
- *Të përshkruaj çdo pajisje të blerë;*
- *Të evidentoj çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose per të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit);*
- *Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues.*

- *Të gjitha aplikimet të cilat nuk do ta kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.*

- *Ju lutemi që raportin ta shkruani në* ***<u>formë elektronike</u>*** *(të printuara).* ***<u>Raportet me dorëshkrim nuk pranohen.</u>***

- **Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse, kati i parë në Komunën e Podujevës, në zarfe të mbyllura.**

- *Nuk do merren në shqyrtim OJQ-të, të cilat nuk janë treguar të përgjegjshme në deklarimin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitet paraprake.*

- *Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.*

Këtë mund ta bëni dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Adresa është e njëjtë në të dyja rastet:

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**
**Rruga "Nuhi Gashi", Kutia postare 1001**

*Në zarf të shkruhet qartazi:*

**Drejtuar Zyrës së Shërbimit për qytetarë në Komunën e Podujevës:**
**Aplikim në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime për vitin 2023**
**Emri i aplikantit: ________________________________________**
**Titulli i projektit: ________________________________________**

*DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT, DO TË VAZHDOJ PROCEDURAT E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE KONFORM DISPOZITAVE TË PËRCAKTUARA LIGJORE.*

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË/O

*DREJTOR*
*për Kulturë, Rini dhe Sport*
____________________
*Pajtim Balaj*

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

# Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

## DEKLARATË MBI FINANCIMIN E DYFISHTË

**Deklaroj se:**

**Aplikuesi:**

______________________________________________________________________________

**(Emri)**

1.Ka konkurruar për financimin e projektit/programit, por procesi i vlerësimit të projekt/programit është ende në proces.

______________________________________________________________________________

**(Emri i institucionit dhe thirrjes publike në të cilën projekti ka konkurruar)**

Nën përgjegjësi penale dhe materiale deklaroj se të gjitha informatat e përfshira në deklaratë janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Vendi dhe data                                        Emri i plotë dhe nënshkrimi

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

---

**Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

*FORMULARI I* PROJEKT/PROPOZIMIT

Ju lutemi para se të plotësoni formularin lexoni me kujdes udhëzimet për dorëzim.

Forma duhet të plotësohet me kujdes dhe sa më qartë që të jetë e mundur në mënyrë që të mund të bëhet një vlerësim sa më i mirë i cilësisë së projekt-propozimeve. Informatat duhet të jenë të sakta, të plota në mënyrë që të japin detaje të mjaftueshme për të kuptuar në mënyrë të qartë project-propozimin.

**Emri i projektit/propozimit:**______________________________________________________

**Emri i aplikuesit:**________________________________________________

| **I. INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN E PROJEKTIT** | |
|---|---|
| **INFORMACION BAZË PËR ORGANIZIMIN E APLIKUESIT** | |
| 1. Emri i aplikuesit | |
| 2. Adresa (rruga dhe numri) | |
| 3. Kodi postar | |
| 4. Nr. Tel. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. Adresa postare | | | | |
| 6. Email adresa | | | | |
| 7. Numri llogarisë bankare përfshirë IBAN | | | | |
| 8. Qëllimi dhe fushëveprimi i projektit | | | | |
| 9. Numri i atyre të cilët punojnë vullnetarisht (nwse ka) | | | | |
| 10. Numri i të punësuarve në ditën e dorzimit të projektit *(nwse ka)* | Të punësuar për kohë të kufizuar | | Për një kohë të pacaktuar | |
| 11. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare publike në vitin para shpalljes së thirrjes (nwse ka) | | | | |
| 12. Njohja e aplikuesit përmes projekteve të financuara nga burimet publike të financimit gjatë viteve paraprake<br>*(Ju lutem specifikoni projektet/ propozimet e financuara nga burimet publike të financimit, duke* | | | | |

| |
|---|
| *përfshirë edhe emrin e institucioneve/ofruesve të mbështetjes financiare publike nga të cilat ju keni pranur mbështetje financiare gjatë dy viteve të fundit para shpalljes së kësaj thirrje publike.*) |
| |
| **II. INFORMACION MBI PROJEKTIN / PROPOZIMIN** |
| 1. Emri i projektit /programit: |
| |
| 2. Përmbledhje e projektit/propozimit *(një prezantim i shkurtër i informacionit bazë për projektin/propozimin)* |
| |
| 3. Kohëzgjatja e pritur e implementimit të projektit/propozimit në muaj: |
| |
| 4. Fusha në të cilën do të implementohet projekti/propozimi *(ju lutem specifikoni fushën e veprimit social dhe politikat publike në të cilat projekti/propozimi do të aplikohet)* |
| |

| | |
|---|---|
| 5. Shuma totale e kërkuar për zbatimin e projektit/propozimit: | |
| 6. Përshkruani rezultatet e matshme që ju i prisni në fund të zbatimit të projektit/propozimit tuaj: | |

| |
|---|
| |
| 7. Një përshkrim i detajuar i projektit/propozimit |
| |
| 8. Kush janë përfituesit përfundimtarë të projektit *(individët, grupet, organizatat që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e projektit, por që implementimi i projektit do të ketë tek ata një efekt të tërthortë)?* Si do të ndikojë projekti tek ato grupe? *(Ju lutem specifikoni):* |
| |
| 9. Përshkruani, aktivitetet kryesore që do të kryhen në kuadër të projektit, bartësit, rezultatet e pritura, periudha e zbatimit të tyre, metodat që do të përdoren në zbatimin e projektit *(nëse është e nevojshme perdorni faqen prapa)* |
| |
| 10. Listoni aktivitetet më të shpeshta që kryhen në projekt/propozim |
| |
| 11. Ju lutem tregoni se cili lloj i aktiviteteve të tjera do të kryhet në kuadër të projektit/propozimit |

| | |
|---|---|
| | |
| 12. Personat përgjegjës për zbatimin e projektit / propozimit (nwse ka) | |
| a) Udheheqesi/drejtuesi i projektit/propozimit *(shkruani emrin dhe bashkangjitni një CV)* | |
| b) Kontraktorët *(shkruani emrin, përshkrimin e përvojës dhe kualifikimeve të mëparshme)* | |
| 13. Numri i vullnetarëve që marrin pjesë në projekt/program *(specifikoni numrin e vullnetarëve dhe numri i orëve vullnetare të parashikuara në projekt/program)* | |
| 14. Përshkrimi i aktiviteteve të cilat vullnetarët do të kryejë për zbatimin e projektit *(për secilën kategori dhe llojin e punës vullnetare)* | |
| 15. Numri i personave të punësuar të përfshirë në zbatimin e projektit / programit *(specifikoni për të gjitha organizatat)* | |
| 16. Ekspert/et, bashkëpunëtorët / e jashtem te cilët jane përfshirë në projekt / program *(shëno emrin dhe fushat e ekspertizës)* | |
| 17. Përshkrim i shkurtër i përvojave, arritjeve dhe aftësitë e aplikuesit në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me partnerin. *(specifiko aktivitetet/projektet)* të mëparshme dhe të tanishme të cilat organizata aplikuese ka zbatuar, në veçanti të ndërlidhura me thirrjen publike | |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| 18. | Përshkruani se si keni ndërmend të përfshini qytetarët në projekt/propozim dhe për të informuar publikun e gjerë për të arriturat dhe rezultatet e projektit/propozimit. | |
| | | |
| **III.** | **VLERËSIMI I REZULTATEVE** | |
| 1. | Përshkruani rrugën që do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e arritjeve të rezultateve të projektit/propozimit dhe ndikimin e tij në përmbushjen e objektivave të thirrjes publike. | |
| | | |
| **IV.** | **QËNDRUESHMËRIA PROJEKTIT / PROPOZIMIT** | |
| 1. | Përshkruani planet tuaja që do të sigurojnë qëndrueshmërinë e projektit/propozimit pas përfundimit të mbështetjes financiare publike *(financiare, institucionale, në nivelin e zhvillimit të politikave dhe qëndrueshmërisë së mjedisit të aktiviteteve të projektit/propozimit pas përfundimit të projektit)?* | |

Emri dhe mbiemri i udhëheqësit / menaxherit të projektit / programit

Nënshkrimi

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

---

# Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

## FORMULARI I PROPOZIM BUXHETIT

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | Emri | |
| **2.** | Tituli i projektit | |
| **3.** | Lloji i kostos | |
| **4.** | **a)** Kosto direkte (specifiko shpenzimet qe jane te lidhura direct me projektin | |
| **5.** | **b)** Kosto tjera, sherbimet (fushata, trajnime, kostoja e monitorimit te projektit,) | |
| **6.** | Buxheti i pergjithshem i projektit (në euro) | |

**KOMUNA E PODUJEVËS**
**DREJTORA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Duke u bazuar në nenin 62 par 3, nenit 17 pika s të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenit 64.4, nenit 19 pika 1.19, të Statuit të Komunuës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 dt 29.06.2018, nenit 27 dhe 28 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së Subvencioneve, me nr. 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, DKRS publikon:

# THIRRJE PUBLIKE

**Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve individuale, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Komunën e Podujevës.**

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, u bënë thirrje individëve, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve kulturore dhe artistike, duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.

2. Individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike.

3. Individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon jetën kulturore, përmes aktiviteteve si më poshtë:

**Ngjarje/Aktivitete kulturore, artistike, tradicionale:**

- *Artin pamor (ekspozita);*
- *Art në hapësira publike;*
- *Botim i librit dhe promovim;*
- *"Stand up" komedi;*
- *Aktivitete të tjera kulturore dhe artistike.*

**Objektivi i thirrjes:**

*Përfshirja e individëve në krijimin, masivizimin, rritjen e cilësisë, zgjerimin/shtrirjen e ngjarjeve/aktiviteteve kulturore dhe artistike.*

**Objektivat:**

- *Krijimi i ngjarjeve/aktiviteteve kulturore dhe artistike nëpërmjet partneritetit me individët në fushat e kulturës dhe arteve;*

- *Përfshirja ideve dhe potencialit të individëve në funksion të ringjalljes së jetës kulturore dhe artistike;*
- *Rritja e cilësisë së krijimtarive në kulturë dhe arte, nëpërmjet mbështetjes së ideve, propozimeve dhe ngjarjeve/aktiviteteve;*
- *Shtrirja dhe zgjerimi i ngjarjeve/aktiviteteve në zona rurale;*
- *Përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes në ngjarje/aktivitete të grupeve të margjinalizuara;*

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione për këto lloj projektesh për këtë vit është 10,000 € (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 300 € (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 2,000€ (euro).

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 24.03.203 dhe përfundon me datën 06.04.2023 në ora 16:00.

6. Individët mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Periudha e zbatimit të projektit është 15.04.2023 - 25.12.2023.

**Kriteret e përgjithshme për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për projekte individuale:**

- Projektet duhet të zbatohen në Komunën e Podujevës;

- Projektet dhe individët aplikues mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;

- Individët të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje dhe nuk mund të përzgjidhen fituese;

- Projektet duhet të reflektojnë nevojat dhe objektivat e Komunës së Podujevës për këto fusha;

- Të mos ekzistoj konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

- Individët nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës;

- Individët duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si të cekura më lartë;

- Të dëshmoj kompetencë profesionale për zbatimin e projektit.

**Kriteret e veçanta:**

1. Art pamor:

   a) Portfolio e artistit/es;

   b) Listë e punimeve që prezantohen;

   c) Koncept vizual i veprës.

2. Art në hapësira publike:

   a) Portfolio e artistit/es;

   b) Listë e punimeve që prezantohen;

   c) Koncept vizual i veprës;

   ç) Të kërkohet leje nga drejtoria përkatëse komunale para aplikimit.

3. Botime librash:

   a) Biografi e autorit/es;

   b) Rezencion i veprës;

   c) Zjë pjesë e veprës që do të botohet;

   d) Prezantim i ilustrimeve (nëse ka);

   e) Marrëveshje me shtëpinë botuese (nëse ka).

4. Stand up comedy (komedi individuale)

   a) Biografi e performuesit

   b) Teksti i performancës

5. Në projekte të tjera kulturore, të ofrohen dëshmi të ngjashme me ato të sipërpërmendurat.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në Rregullore per kushtet kriteret dhe procedurate ndarjes se Subvencioneve (2).pdf

**Kujdes: Aplikacionet të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.** Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike. Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.
Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: ***jakup.gashi@rks-gov.net dhe arber.sfishta@rks-gov.net*** **ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.**

**Lista e dokumenteve të thirrjes publike**

- **Për individët:**
  - Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të individit (JO kopje e kartelës bankare);
  - Kopjen e letërnjoftimit;
  - Deklarta për financimin e dyfishtë; (nëse ka)
  - Formulari i projekt-propozimit të thirrjes publike;
  - Formulari i propozim-buxhetit;
  - Krahas kësaj liste, varësisht nga fusha artistike, shtohen dokumentet e kërkuara tek kriteret e veçanta.

**Vërejtje/Kujdes**:

- ***Raporti Narrativ*** *- i cili përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit qoftë nëpërmjet dëshmive të fotografimit. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga Personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione. Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit projektit.*

*Raporti narrativ i përgatitur duhet të përfshij:*

- *Të përfshij dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve, etj).*
- *Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues të subjektit grantmarrës.*

- ***Raporti Financiar*** *– kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim iu është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor të projektit.*

*Raporti financiar i përgatitur duhet të deklarohet dhe:*

- *Të përshkruajë shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera;*
- *Të përshkruaj çdo pajisje të blerë;*
- *Të evidentoj çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose per të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit);*
- *Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues.*

- *Të gjitha aplikimet të cilat nuk do ta kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.*
- *Ju lutemi që raportin ta shkruani në **formë elektronike** (të printuara). **Raportet me dorëshkrim nuk pranohen.***

- **Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse, kati i parë në Komunën e Podujevës, në zarfe të mbyllura.**

- *Nuk do merren në shqyrtim OJQ-të, të cilat nuk janë treguar të përgjegjshme në deklarimin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitet paraprake.*

- *Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.*

Këtë mund ta bëni dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Adresa është e njëjtë në të dyja rastet:

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**
**Rruga "Nuhi Gashi", Kutia postare 1001**

*Në zarf të shkruhet qartazi:*

**Drejtuar Zyrës së Shërbimit për qytetarë në Komunën e Podujevës:**
**Aplikim në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime për vitin 2023**
**Emri i aplikantit: __________________________________________**
**Titulli i projektit: __________________________________________**

***DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT, DO TË VAZHDOJ PROCEDURAT E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE KONFORM DISPOZITAVE TË PËRCAKTUARA LIGJORE.***

*DREJTOR*
*për Kulturë, Rini dhe Sport*

________________________________
*Pajtim Balaj*